



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 11.02.2020

Ref: 149/200

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), nenin 108 të Ligjit mbi procedurën administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016) Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KShC), mori:

**V E N D I M**

Për korrigjimin e vendimit Nr. 558/14, datë 04.07.2014 të Kolegjit Iliria

- I. Korrigjohet pika I, paragrafi 3, i vendimit të KShC-së Nr. 558/14, datë 04.07.2014, në të cilën ndryshohet titulli i programit nga *Inxhinieri Softuerike/MA (120 ECTS)* në *Inxhinieri Softuerike/MSc (120 ECTS)*
- II. Pjesa tjetër e vendimit të KShC-së Nr. 558/14, datë 04.07.2014, mbetet e pa ndryshuar.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

**Arsyetimi**

Kolegji Iliria ka parashtruar kërkesë për përmirësim të vendimit të KSHC-së Nr. 558/14, datë 04.07.2014, në pikën I, paragrafi 3. Pas dëshmive të ofruara dhe verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, është konstatuar se gjatë lëshimit të vendimit për akreditim Nr. 558/14, në vend se të vendoset emri i programit të studimit *Inxhinieri Softuerike/MSc (120 ECTS)*, AKA ka vendosur gabimisht emrin e programit *Inxhinieri Softuerike/MA (120 ECTS)*. Prandaj përmes këtij vendimi, mbi bazën e dëshmive të ofruara, KShC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Iliria;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



---

Prof. Dr. Gazmend Luboteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë